



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI**

Nr 2806/16 Prot.

Pogradec, më 29.07.2025

**VENDIM**

**NR. 61, DATË 29.07.2025**

**MIRATIMI I RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES, SIPAS NENIT 53, PIKA 5, LIGJI  
139/2015**

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi shqyrtoi me këshilltarët dhe miratoi propozimet e paraqitura si dhe pikat e rendit të ditës të njoftuara për vendimarrje në njoftimin për mbledhjen e datës 28.07.2025, në mbështetje të ligjit nr 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 54, gërma k, si dhe neni 97, pika 2 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

**KËSHILLI I BASHKIAK**

**VENDOSI:**

1. Të miratojë rendin e ditës për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Pogradec me pikat si më poshtë:
  - 1.1 Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
  - 1.2 Deklarimi I konfliktit të interesit** nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
  - 1.3 Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 25.06.2025.
  - 1.4 Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit** për mbledhjen e datës 25.06.2025.
  - 1.5 Projekt – Vendim :** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Qershor 2025.
  - 1.6 Projekt – Vendim:** Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Pogradec ( fazal)
  - 1.7 Projekt – Vendim:** Miratimin e planit të masave për të dalë nga gjendja me problem financiare.
  - 1.8 Projekt – Vendim:** Për miratimin e bonusit të qerasë për znj.Mirela Basholli në Bashkinë Pogradec.
  - 1.9 Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës financiare për znj. Dhurata Balliu, familje që ka pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/ paisje elektroshtëpiake si pasojë e përmytjeve.



- 1.10 **Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës financiare z.Agron Qose, Trebinjë, Bashkia Pogradec, për shkak të dëmtimit të banesës nga rënia e zjarrit.
- 1.11 **Projekt – Vendim:** Disa shtesa në vendimin e Këshillit Bashkiak nr 124, datë 27.11.2024 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë”
- 1.12 **Projekt – Vendim:** Për një shtesë në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.105, datë 02.12.2021 për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave publike” dhe “Harta që përcakton rrugët e qytetit , të cilat përjashtohen nga kjo rregullore”, I ndryshuar.
- 1.13 **Projekt – Vendim:** Për dhënie ndihme financiare për z. Edmond Piperi.
- 1.14 **Projekt – Vendim:** Për miratimin e planit të arsimit parauniversitar të Bashkisë Pogradec
- 1.15 **Projekt – Vendim:** Për miratimin në parim të dhënës me qira, në favor të individëve kërkues për kryerjen e operacioneve të kërkim –zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objekteh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe të pasurisë me sipërfaqe totale 40000 m2 ( njëzet mijë e katërqind) m2.
- 1.16 Informacion për “Barometri I barazisë gjinore, Bashkia Pogradec, 2024 ”
- 1.17 Të tjera.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 19 vota

2.Vota Pro 19

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 28.07.2025